

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga fshati ..., Komuna e Istogut, të cilin e përfaqëson i autorizuari O.L., avokat nga Peja, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Njësia e Standardeve Profesionale në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar N.A., zyrtare ligjore, për shkak të kthimit në vendin e punës, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit dhe ankesës së të autorizuarës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.242/12, i datës 10.06.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 10.05.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditësit A.M. nga fshati ..., Komuna e Istogut, dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.242/12, i datës 10.06.2013, në pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit me të cilën është vendos që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e të gjitha të ardhurave duke filluar nga data 15.10.2003, me kamate ligjore deri në kthimin e tij në punë, si e pathemeltë.

II. APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Njësia e Standardeve Profesionale në Prishtinë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.242/12, i datës 10.06.2013, në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit dhe vendoset: HEDHET poshtë padia e paditësit A.M. nga fshati ..., Komuna e Istogut, e datës 28.03.2007, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet si i kundërligjshëm vendimi për largimin nga puna Nr.343 i ish-SHPK/2003, i datës 15.10.2003, dhe kërkesa që të detyrohet e paditura që ta kthejë në vendin dhe detyrat e punës në Policinë e Kosovës, SI E PASAFATSHME.

III. APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Njësia e Standardeve Profesionale në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.242/12, i datës 10.06.2013, në pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit dhe VENDOSSET që secila palë ndërgjyqësore ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog me aktgjykimin e atakuar C.nr.242/12, të datës 10.06.2013, me pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ashtu që ka vendosur se është i kundërligjshëm vendimi për largimin nga puna, Nr.343 i ish-SHPK/2003, i datës 15.10.2003, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit A.M., nga fshati ..., Komuna e Istogut dhe e ka obliguar Ministrin e Punëve të Brendshme-Njësia e Standardeve Profesionale në Prishtinë që të njëjtin ta kthejë në punë në detyrat e punës në Policinë e Kosovës, si e bazuar.

Me pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për pjesën që ka të bëjë me kompensimin e të gjitha të ardhurave personale duke filluar nga data 15.10.2003, ma kamatë ligjore, deri në kthimin në punë, si e pathemeltë.

Me pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar e ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve procedurale ti paguaj shumën prej 1000 Euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit duke e atakuar aktgjykimin e goditur vetëm në pikën II (dy) të dispozitivit dhe atë për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave në fuqi, me propozim që të aprovohet ankesa e të autorizuarit të paditësit ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet vetëm në pikën II (dy) të dispozitivit dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit lidhur kompensimin e të gjitha të ardhurave personale, kurse e autorizuarja e të paditurës me ankesë aktgjykimin e ka atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e pa bazuar, ndërsa ankesa e të autorizuarës së të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, A.M. nga fshati ..., Komuna e Istogut me datën 28.03.2007, në ish-Gjykatën Komunale në Istog ka paraqitur padi kundër të paditurit Shërbimi Policor i Kosovës-Drejtorati i Standardeve Profesionale në Prishtinë me kërkesë që të vërtetohet si i kundërligjshëm dhe arbitrar vendimi i të paditurës nr.343/SHPK/2003, i datës 15.10.2003, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, të detyrohet i padituri që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës duke filluar nga data 15.10.2003 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit me aktvendimin C.nr.56/07, i datës 03.04.2007, e hedhë poshtë si të pasafatshme padinë e paditësit me arsyetim se paditësi ka kërkuar mbrojtje gjyqësore pas kalimit të afatit prej 30 ditësh, afat i cili përcaktohet me Ligjin mbi Punën e Bashkuar neni 224.

Gjykata e Qarkut duke vepruar sipas ankesës së paditësit e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, me aktvendimin Ac.nr.148/07, i datës 10.03.2008, e prishë aktvendimin e Gjykatës Komunale në Istog C.nr.56/07, të datës 03.04.2007, dhe lëndën ia kthen të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pasi që lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë e njëjta me aktvendimin C.nr.56/08, i datës 09.06.2008, e shpallë veten jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në çështjen kontestuese të paditësit me të paditurën SHPK-Drejtorati i Standardeve në Prishtinë, me arsyetim se për këtë çështje duhet të vendosë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës si organ kompetent.

Gjykata e Qarkut në Pejë duke vendosur sipas ankesës së paditësit, me aktvendimin e saj Ac.nr.298/08, i datës 10.12.2008, e prishë aktvendimin e Gjykatës Komunale në Istog C.nr.56/08, të datës 09.06.2008, dhe lëndën ia kthen të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pasi që lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë e njëjta me aktvendimin e saj C.nr.333/08, të datës 16.01.2009, e hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësit me arsyetim se për çështjen e njëjtë ekziston vendimi i formës së prerë C.nr.191/03, i datës 23.02.2004, i formës së prerë nga data 10.03.2004, me të cilin ishte hedhë poshtë si e palejuar padia e paditësit.

Gjykata e Qarkut në Pejë me aktvendimin e saj Ac.nr.52/09, i datës 11.11.2009, e refuzon ankesën e të autorizuarit të paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton aktvendimin e Gjykatës Komunale në Istog C.nr.333/08, i datës 16.01.2009, me të cilin ishte hedhur poshtë padia e paditësit si çështje e gjykuar.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas revizionit të t' autorizuarit të paditësit me aktvendimin e saj Rev.nr.11/2010, i datës 18.09.2012, e ka prishë aktvendimin e Gjykatës Qarkut në Pejë Ac.nr.52/09, i datës 11.11.2009, dhe aktvendimin e Gjykatës Komunale në Istog C.nr.333/08, i datës 16.01.2009, ndërsa lëndën e ka kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata Supreme e ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që përveç të tjerave paraprakisht të vlerësojë afatëshmërin e padisë dhe pas vlerësimit të gjitha provave të merr vendim të ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.242/12, i datës 10.06.2013, me pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka vërtetuar si të kundërligjshëm Vendimin për largim nga puna nr.343 i ish SHPK/2003 i datës 15.10.2003 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit dhe e ka obliguar të paditurën që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, ndërsa me pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar kërkesëpadinë paditësit që ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale duke filluar nga data 15.10.2003, me kamatë ligjore e deri në kthimin e tij në punë, kurse me pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit e ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumën prej 1000 Euro.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se paditësi nuk ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës për çka i është shqiptuar masa disiplinore largim nga puna e cila ka mbetur në fuqi nga vendimi i Bordit të Ankesave të t'paditurës i datës 11.11.2003, ndërsa paditësi brenda afatit ligjor prej 30 ditësh ka parashtruar padi në gjykatën kompetente me datën 08.12.2003. Gjykata ka shtuar se sa i përket pikës II të dispozitivit që ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale ka vlerësuar se paditësi nuk i ka specifikuar dhe nuk ka kontribuar në procesin e punës në mënyrë që ti gëzojë ato.

Gjykata e Apelit duke e ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas pretendimeve ankimore të t'paditurës gjen se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i pa bazuar për shkak se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (e) e LPK-së, e për shkak të shkeljes që kualifikohet në kuptim të dispozitës së nenit 182 paragrafi 2 pika (e) e LPK-së, gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket afatit për paraqitjen e padisë në gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit paraprak të padisë është e detyruar ti vlerësojë të gjitha prezumimet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor përfshirë edhe prezumimin që lidhet me afatin për paraqitjen e padisë në gjykatë.

Për këtë rrethanë me dispozitën e nenit 391 pika (f) e LPK-së parashihet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:.... (pika f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”* Në rastin konkret edhe sipas aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.11/2011, i datës 18.09.2012, ishte udhëzuar gjykata e shkallës së parë që përveç tjerave të vlerësojë edhe afatëshmërin e padisë e pastaj të marr vendim të ligjshëm.

Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pavarësisht se gjykata e shkallës së parë nuk i ka eliminuar shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat ishte udhëzuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që me dispozitën e nenit 190 paragrafi 3 i LPK-së përcaktohet detyrimi që gjykata e shkallës së dytë të vendosë vetë kur në çështjen konkrete më parë ishte anuluar dy herë vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Në përfundimin se duhet të priset aktgjykimi në pjesën e goditur me ankesë nga e paditura dhe duhet të hedhet padia si e palejuar Gjykata e Apelit erdhi duke vepruar në kuptim të dispozitës së nenit 391 pika (f) e LPK-së, me referencë të dispozitave të ligjit material që përcakton afatin për ngritjen e padisë.

Sipas dispozitës së nenit 83 paragrafi 1 i Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës (aprovuar nga Kuvendi i RSFJ-së, në seancën e Dhomës Federative më 28.09.1989) përcaktohet se *“Punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent në organizatë, ose në qoftë se ky organ nuk merr vendimin brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, përkatësisht të kundërshtimit, ka të drejtë që në afatin e ardhëm prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente”*. Në kuptim të afatit që përcaktohet me këtë dispozitë rrjedh se padia e paditësit për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës me të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës është e pasafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë për kthim në vendin e punës në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur me datë 28.03.2007, ndërsa paditësi nga vendi i punës ishte larguar sipas njoftimit të datës 15.10.2003, pra padia është paraqit pasi ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e padisë.

Gjykata e Apelit për paafatshmërinë e padisë iu referua dispozitës së nenit 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, pasi që ligj i aplikueshëm për afatin në kohën kur është largua paditësi nga puna ka qenë ky ligj.

Në lidhje me ankesën e të autorizuarit të paditësit për të cilën është vendosë si në pikën I të këtij dispozitivi, gjykata vendosi në kuptim të dispozitës së nenit 203 të LPK-së.

Për shpenzimet e procedurës si në pikën III (dy) të dispozitivit, u vendos në kuptim të nenit 452 paragrafi 4 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (b) dhe (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 2659/13, me datë 10.05.2016

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v.